



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Buletini i aktiviteteve për muajin Qershor 2024

1.06.2024

Në këtë ditë të veçantë, sidomos për fëmijët, Kryetari Shaqir Totaj mori pjesë sonte në Festivalin e Fëmijëve "Fluturat" në Prizren.

Ky festival është një mundësi e shkëlqyeshme për ta festuar fëmijërinë dhe për të promovuar krijimtarinë dhe talentet e fëmijëve tanë.

Festivali sjell gëzim dhe argëtim për të vegjlit, duke u ofruar atyre një platformë për ta shprehur veten dhe për ta ndarë gëzimin e tyre me komunitetin.

"Urime të gjithë fëmijëve për 1 Qershorin - Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve!" - uroi Kryetari Totaj.



02.06.2024

Kështu duket oborri i Qendrës Sportive "Sezai Surroi" në Prizren, pas përfundimit të shtrirjes së rrjetit të ndriçimit publik, një projekt i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



05.06.2024

U shtrua sot shtresa e parë e asfaltit në rrugën “Ymer Shala” (ish rruga “Ulqini”) në Prizren, një aks i rëndësishëm që lidh lagjet dhe ngritë cilësinë e jetës së banorëve dhe bizneseve të zonës.



05.06.2024

Me një ceremoni solemne, sot, u bë shpërndarja e certifikatave për 70 gra të Komunës së Prizrenit që kanë vijuar kurse gjashtë mujore për pirografi, relief në letër, kurdele, bizhuteri, rrobaqepësi dhe dizajn të modës - projekt i realizuar nga Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me Komunën e Konyas së Republikës së Turqisë, i organizuar nga Organizata “Komek”, që ka për qëllim fuqizimin dhe aftësimin profesional të grave prizrenase.

Pjesëmarrëset shfaqën punimet e tyre gjatë kësaj ceremonie duke demonstruar kështu kreativitetin dhe aftësitë e fituara gjatë kurseve profesionale.



06.06.2024

Në nderim të jetës dhe veprës së martirëve të Kabashit të Hasit, sot, drejtori i DKRS-së, Adem Morina, vendosi kurorë lulesh në Memorialin e të rënëve dhe bëri homazhe në varrezat e tyre.

Me dhembje dhe krenari u kujtuan të gjithë ata që u flijuan për liri, në 25 vjetorin e rënies, të cilët u shndërruan në themeltarë të Kosovës së Pavarur.



08.06.2024

Pas renovimit të tërësishëm të Ambulancës së Mjekësisë Familjare në fshatin Mushnikovë, KFOR-i italian dhuroi donacion prej 6.000 eurosh për këtë AMF, pajisje mjekësore të cilat do ta përmirësojnë cilësinë e shërbimeve për banorët e zonës.

§□Dhurimin e mjeteve medicinale e bëri Komandanti i KFOR-it italian, kolonel Francesco Ferrara, i cili deklaroi se do të vazhdojnë ta ndihmojnë mjekësinë familjare në mënyrë që të ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve.



10.06.2024

Kryetari Shaqir Totaj, me ftesë të Ministrisë së Jashtme Federale mori pjesë në Programin një javor të Vizitorëve të Republikës Federale të Gjermanisë, ku, nga të gjitha shtetet e Ballkanit, Komuna e Prizrenit dhe ajo e Therandës përfaqësuan Kosovën me diskutime për forcimin e rolit të komunave.

Zhvilluan takime dhe vizita në lokacione specifike, duke shtjelluar strategjitë e nevojshme për t'i përmbushur detyrat brenda Bashkimit Evropian, që janë hap i rëndësishëm drejt integritetit evropian dhe bashkëpunimit të thellë ndërkombëtar për Prizrenin e Kosovën në tërësi.

Gjatë qëndrimit në Berlin, Koln dhe Essen, patën takime të rëndësishme në Ministrinë e Jashtme Gjermane, në Zyrën e Kancelarit si dhe në Asociacionin e Qyteteve Gjermane dhe Evropiane, me ç'rast, ndër të tjerë, bashkëbiseduan edhe me z. Henrike Viehrig, Zëvendës Komisioner Evropian, z. Andrea Zuber, shef i Departamentit të Drejtësisë, Financave dhe Tatimeve, z. Jannis von Oy,

Drejtor i Njësisë për Marrëdhënie Dypalëshe me Shtetet e Evropës Qendrore, Lindore, Juglindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore, etj.



10.06.2024

Madhështia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, përvjetori i 146-të i saj, u kremtua sonte me një koncert madhështor të pianistes prizrenase me famë botërore, Lule Elezi, të shoqëruar me Orkestrën e Harqeve të Tiranës e dirigjuar nga maestro Oleg Arapi.

🎵 Beethoveni e Chopini me virtuozyt kumbuan me notat e tyre në Kinemanë Lumbardhi, para publikut të mrekullueshëm, vlera artistike të cilat Prizreni i ka kultivuar gjithmonë.

Urime përvjetorin e Lidhjes së Prizrenit!



12.06.2024

Prizrenit iu shtua edhe një perlë turistike - "Kalaja e UÇK-së", në malet e fshatit Leskovec, në zonën ku me gjithë goditjet e okupatorit serb, Ushtria Çlirimtare e Kosovës triumfoi si autore e shtetit të Kosovës.

Përurimi i kësaj vepre, që mbanë shkronjat e ushtrisë sonë të shenjtë, UÇK-së, është nder dhe krenari për Komunën Prizrenit e cila Kala çdo ditë do të na kujtoj sakrificën e vajzave dhe djemve trimë që më 12 qershor 1999 edhe e çliruan Prizrenin.



14.06.2024

Kryetari Shaqir Totaj prit sot Andreas Wil Gerdes, themelues i lëvizjes MaNaBu - organizatë amerikane jofitimprurëse që ofron mundësi të arritshme për të rinjtë për ta arritur potencialin e plotë përmes aftësive praktike, komunitetit, bashkëpunimit dhe përvojave të jetës jashtë shkollës, i shoqëruar me Arbër Kryeziun, bashkëthemelues i Makerspace Innovation Center Prizren.

Me këtë rast diskutuan mbi mundësitë e punës në distancë për të rinjtë e Prizrenit, në mënyrë që qyteti ynë të pozicionohet si destinacion kryesor në Kosovë për nomadët dixhitalë, duke u mundësuar të rinjve tanë zhvillimin profesional, qasjen në punët botërore dhe pavarësinë ekonomike.

Së bashku, u zotuan për fuqizimin e rinisë prizrenase përmes aftësimit dhe ofrimit të mundësive të nevojshme për ndjekjen e ëndrrave nga vendi i tyre, Prizreni.



18.06.2024

Drejtoria e Shërbimeve Publike po vazhdon me projektet e zhvillimit infrastrukturor në fshatin Nashec, me ç'rast janë ndërtuar mure mbrojtëse dhe do të shtrohen me kubëza 25 akse rrugore, të cilat përmirësojnë qasjen dhe sigurinë për banorët, duke krijuar kushte për zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit lokal.



20.06.2024

Kryetari Shaqir Totaj dhe nënkryetari Kujtim Gashi morën pjesë sot në mbylljen e kampit “House of STEM” që u mbajt në Prizren - një projekt që u iniciua nga ish-studentët e programit TechGirls të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve.

Ky projekt mblodhi vajzat nga Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi, të moshës 15-18 vjeçe, të cilat gjatë pesë ditëve të kampit takuan ndërmarrës të ndryshëm, shkencëtarë, profesorë dhe ekspertë të fushës STEM, mësuan rreth STEM-it dhe diskutuan për tema të zhvillimit personal si dhe vizituan kompanitë STEM në Prishtinë.

“House of STEM“ financohet nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, përmes "Alumni Engagement Innovation Fund 2023", ndërsa administrohet nga KUSA.



20.06.2024

Kryetari Shaqir Totaj priti sot kryetarin e qytetit Porto të Portugalisë, Rui Moreira, me një delegacion të gjerë me biznesmenë portugezë, me ç'rast nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi për nxitjen, inkurajimin dhe krijimin e urave të bashkëpunimit në fushat e turizmit, ekonomisë, kulturës e të sportit mes Prizrenit dhe Portos.

Me iniciativë të Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Portugali, Ylber Kryeziu, ky Memorandum hapë rrugë për bashkëpunim në projekte të përbashkëta konkrete me synim krijimin e beneficioneve për të dy popujt, sidomos për të rinjtë.

"Porto është një qytet që i ngjanë Prizrenit me kulturë, histori unike dhe traditë, që do të jetë kënaqësi ta zgjerojmë bashkëpunimin me këtë qytet evropian me vlera" - u shpreh Kryetari Totaj.



21.06.2024

Kryetari Shaqir Totaj, së bashku me nënkryetarin Kujtim Gashi morën pjesë në eventin përmbyllës “Demo Day” të kohortës së dytë të programit “Idea-to-Scale”, që ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të rinjve prizrenas që ndihmoi në zhvillimin dhe lansimin e 11 bizneseve të reja (Start-Up) në Prizren dhe më gjerë, duke ngritur mundësitë dhe sukseset gjatë ngritjes së tyre profesionale.

□Ky program implementohet nga Makerspace Innovation Center në ITP Prizren, në kuadër të Digital Transformation Center dhe përkrahet nga Komuna e Prizrenit, GIZ Kosovo dhe Swiss EP Kosovo.



22.06.2024

Drejtoria e Shërbimeve Publike po punon në një seri projektesh të rëndësishme infrastrukturore në Piranë, me ç'rast është shtruar kanalizimi fekal brenda fshatit (600 metra), ndërsa, tetë rrugë po shtrohen me kubëza.



23.06.2024

Kryetari Shaqir Totaj mori pjesë sot në hapjen e festivalit më të madh të çiklizmit në Kosovë "Bikefest" ku bënë edhe një xhiro me biçikleta përgjatë rrugës unazore të qytetit me moton "Pedalo me pasion, festo me Bikefest" që organizohet nga K.Ç. Pro Bike Prizren dhe mbështetet nga Komuna e Prizrenit.

♂♀ "Ishte i bukur bashkimi i entuziastëve të biçikletave nga Kosova dhe rajoni për aktivitete sportive, rekreative, argëtuese dhe edukative në Prizren, duke promovuar kulturën e çiklizmit, stilin e shëndetshëm të jetë dhe ndërgjegjësimin për ruajtjen e mjedisit" - u shpreh me këtë rast Kryetari Totaj.



24.06.2024

Po punohet me dinamikë të shtuar në sheshin "Shatërvan", pas ndërtimit të infrastrukturës nëntokësore, që do ta rikthej pamjen e merituar të qendrës së Prizrenit.

<https://www.facebook.com/watch/?v=311899505222545>

27.06.2024

Rock and Blues Festival po vjen!

☐♂ Në një atmosferë të ngrohtë e të këndshme, mbrëmë u mbajt festa para fillimit zyrtar të festivalit më 4, 5 dhe 6 Korrik.

🎵 Ftoheni të gjithë në edicionin e sivjetmë ku në skenën e madhe do të frekuentojnë super emra të muzikës rock dhe blues që shënon një ngjarje të madhe në Prizrenin e festivaleve. 🎵



28.06.2024

Kryetari Shaqir Totaj nënshkroi Memorandum Bashkëpunimi me përfaqësuesit e KFOR-it shqiptar dhe italian të cilët po e promovojnë shkëmbimin e universiteteve “Ukshin Hoti” në Prizren, “Fehmi Agani” në Gjakovë dhe “Haxhi Zeka” në Pejë si dhe Komunat e Kosovës Perëndimore.

Me këtë rast, të gjitha palët bien dakord ta krijojnë, ta rrisin ndërgjegjësimin dhe ta zhvillojnë programin “Zhvillimi i Turizmit të Qëndrueshëm” për promovimin dhe përmirësimin e kapacitetit turistik të rajonit.

Objektivi kryesor është rritja e ndërgjegjësimit, zbatimi dhe kultivimi i një turizmi të qëndrueshëm e program zhvillimi që përmes zbatimit të burimeve njerëzore, kërkimit dhe inovacionit mund ta përmirësojë turizmin në Kosovën Perëndimore me një vizion të përbashkët.

KFOR-i, për këtë program, ka vënë në dispozicion edhe hapësirën në Kampin Ushtarak Italian (CVI) në Pejë.



29.06.2024

Në një atmosferë të shkëlqyeshme, mbrëmë, në Kinemanë “Lumbardhi”, u mbajt edicioni i 35-të i festivalit tradicional “Zambaku i Prizrenit”, që është krenaria e qytetit.



29.06.2024

Një super event kulturor u mbajt sonte në Parkun e Qytetit në Prizren - Festivali i Motoristëve "MC Eagles Moto Fest 2024", i mbështetur nga Komuna e Prizrenit.

🔧Përveç motoçikletave të llojeve të ndryshme që e zbukuruan ambientin dhe motoristët me veshje tipike, muzika ishte në nivelin e lartë, ku interpretuan "Live" Menan Kiseri me kitaristin që ishte vjet në skenën e Rock and Blues Festival, Samuel Federly, pastaj, bendi i njohur Offchestra dhe DJ Trouble.



30.06.2024

Në kuadër të Fiba World Tour, sot, në qendër të qytetit u mbajt turneu tashmë tradicional në streetball "3x3", ku morën pjesë 12 ekipe: nga Prizreni, Prishtina, Peja, Gjakova, Obiliqi, Vushtria, Tetova, etj.

🏀Ky turne unik në basketboll është kualifikues për "Prishtina Challenger" në të cilin garojnë 15 skuadra nga e gjithë bota, përfshirë dhe fituesin e sotëm në edicionin e dytë të kësaj ngjarjeje sportive që mbështetet nga Komuna e Prizrenit.



Kabineti i Kryetarit/Njësia për Komunikim me Publikun